



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 646/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet BPrAL Kolegji “Pjeter Budi” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019.
- II. Riakreditohen programet e studimit për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:
 - Doganë dhe Shpedicion, BA, 180 ECTS, (maksimum 100 student për vit akademik;
 - Menaxhment, MA, 120 ECTS, (me specializime: (Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelërisë; Menaxhimi i Sigurimeve; Menaxhment), (maksimum 60 student për vit akademik).
- III. Riakreditohet programi i studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Menaxhim i Turizmit dhe Hotelërisë, BA, 180 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik).
- IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- V. Obligohet BPrAL Kolegji “Pjeter Budi” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" që deri me datë 1 tetor 2016 ta dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim institucional dhe ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Doganë dhe Shpeditcion	BA	180	Ali Ismajli, Ismail Mehmeti, Muhamed Citaku
2	Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë	BA	180	Sabri Hajdini, Sami Behrami, Bashkim Kastrati
3	Menaxhment	MA	120	Seadin Xhaferi, Gjon Berisha, Dragolub Jankovic

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" me 13.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Tanja Dmtrovic; Prof. Dr. Kristina Tonnisson; Dr. Anca Priscariu; Ms. Simona Dimovska.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Pjetër Budi", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Pjetër Budi”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë